



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT

N J O F T I M

**PËR PROCEDURËN E ANKIMIT TË TESTIMIT TË INFORMATIZUAR TË
MATURANTËVE NË KUADËR TË PRANIMIT NË PROGRAMIN “MJEKËSI E
PËRGJITHSHME” NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË TIRANË**

Bazuar në Rregulloren “Për procedurat dhe mënyrën e zhvillimit të testimit të informatizuar për maturantët në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme”, në Universitetin e Mjekësisë Tiranë”, miratuar me Urdhrin nr. 183, datë 01.11.2022, e ndryshuar të cilën e gjeni të publikuar në faqen zyrtare të Qendrës së Shërbimeve Arsimore www.qsha.gov.al, në linkun:

<https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/08/Rregullore-per-Testimin-e-Informatizuar-te-Maturanteve-ne-Kuader-te-Pranimit-ne-Programin-Mjekesi-e-Pergjithshme-ne-Universitetin-e-Mjekesise.pdf>:

- 1. Kandidati ka të drejtë të ankimojë rezultatin, duke paraqitur ankesën me shkrim, pranë QSHA-së, brenda 1 (një) dite kalendarike nga shpallja e rezultatit të testimit të informatizuar.*
- 2. QSHA-ja shqyrton ankesën dhe kthen përgjigje brenda 1 (një) dite nga paraqitja e ankesës.*

Ju urojmë suksese!